



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT



MINISTRI
LEFTER KOKA

Nr. 167 Prot

Datë 23.01.2017

Nr.i identifikimit të Lejes 2502

K.Nr.01

AKT MIRATIMI
Leje Mjedisi Tipi B

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, Ligji Nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, dhe në zbatim të tyre, pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit jep mendimin për miratimin e lejes me argumentimet bashkëngjitur për kërkuuesin si më poshtë.

1.Personi juridik: BREMA AMBIENTE Sh.p.k (LC – 7914)

1.2 Nr. Nipt: L22316011G

1.3 Adresa: Njësia Bashkiake nr. 5, rruga “Sami Frashëri”, seksioni 3, apartamenti 1, kati 1, zona kadastrale 8270, vol 44, faq 128, Tiranë.

1.4 Personi përgjegjës: Selim Bregu

2.1 Titulli i instalimit: Grumbullim dhe përpunimi i materialeve hekur/jo hekur.

2.2 Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues: Grumbullim dhe përpunimi i materialeve hekur/jo hekur. Sipërfaqja totale ku zhvillohet aktiviteti është 100 000 m².

3.Vendndodhja: Fshati Manskuri, Rrashbull, Durrës.

Vlefshmëria e kësaj leje fillon menjëherë nga data e miratimit të saj.

Operatori duhet të aplikojë pranë AKM-së për përditësimin e kushteve të aktit të miratimit të lejes mjedisore sipas VKM-së Nr. 419, datë 25.6.2014 për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja.

Aplikim i kryer:

- për kërkesë për leje mjedisi.
 Transferim të Lejes Mjedisore PN-1262-01-2011 Ishte: **GRUPPOMAIO.AL** U bë: **BREMA AMBIENTE.**

• **Vendim Nr.417, date 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”**

Operatorët paguajnë në llogari të Ministrisë së Mjedisit tarifën vjetore për instalimet e tipit B, shumën prej 5000 (pesë mijë) lekësh. Tarifa vjetore paguhet brenda 3-mujorit të parë të vitit dhe një kopje e mandat pagesës dorëzohet pranë ARM-së qarkut ku ndodhet instalimi.

4. Kushtet e lejes:

4.1 Kushtet për vendgrumbullimin e makinave të dala jashtë përdorimit (përfshirë ruajtjen e përkohshme) përpara trajtimit të tyre

- 4.1.1 Sipërfaqja ku do të grumbullohen makinat apo pjesët e tyre të dala jashtë përdorimit duhet të jetë e papërshkueshme si dhe të ngrihet sistemi i mbledhjes së rrjedhjeve të lëngjeve, dekantuesit dhe pastruesit vajrave.
4.1.2 Të ngrihet impianti i trajtimit të ujërave sipas projektit teknik tërave sipas projektit teknik të paraqitur për pastrimin e ujërave, përfshirë dhe ujrat e shiut në përputhje që vijnë nga impianti i ruajtjes dhe ndarjes së pjesëve e të makinave.

4.2 Kushte për impiantin e trajtimit, ndarjes dhe zbërthimit të mbetjeve të makinave:

- 4.2.1 Sipërfaqja ku do të trajtohen mbetjet e makinave apo pjesët e tyre të dala jashtë përdorimit duhet të jetë e papërshkueshme si dhe të ngrihet sistemi e mbledhjes së rrjedhjeve të lëngjeve, dekantuesit dhe pastruesit vajrave.
4.2.2 Të ruajë në mënyrë të sigurtë pjesët e zbërthyera, përfshirë pjesët e kontaminuara me vajra.
4.2.3 Të vendosë kontenerë të përshtatshëm për ruajtjen e baterive, filtrave, kondensatorëve që përmbajnë PCB/PCT.

4.2.4 Të kryejë neutralizimin e elektroliteve në një mjedis të përshtatshëm mbi sipërfaqe të papërshkueshme nga lëngjet.

4.2.5 Të vendosë tanke të përshtatshme për ruajtjen e lëngjeve nga zberthimi i pjesëve të makinave: karburant, vaj motorash, vaj transmisioni, vaj hidraulik, lëngjet ftohëse, antifrizë, lëngje frenash, lëngje nga sistemi i ajrit të kondicionuar dhe lëngje të tjera.

4.2.6 Të ngrihet impianti i trajtimit të ujërave sipas projektit teknik të paraqitur për pastrimin e ujërave, përfshirë dhe ujjat e shiut në përputhje me legjislacionin mjedisor.

4.2.7 Të ruajë në mënyrë të sigurtë gomat e përdorura, përfshirë parandalimin e rrezikut nga zjarri në rast të tejkalimit të sasive të grumbulluara.

4.2.8 Të heq nga makinat e përdorura bateritë dhe mbajtësit e gazit të lëngët.

4.2.9 Të largojë apo neutralizojë komponentët potenciale eksplozive, sikurse janë jastekët e ajrit.

4.2.10 Të heq nga makinat e përdorura dhe ti grumbullojë në mënyrë të vecuar karburant, vaj motorash, vaj transmisioni, vaj hidraulik, lëngje ftohëse, antifrizë, lëngje frenash, lëngje nga sistemi i ajrit të kondicionuar dhe lëngje të tjera, nëse nuk mund të ripërdoren.

4.2.11 Të largohen të gjithë komponentët që përmbajnë merkur.

4.3 Operacione të trajtimit në mënyrë që të nxitet riciklimi:

4.3.1 Të vecohen katalizatorët

4.3.2 Të vecohen komponentët metalike që përmbajnë bakër, alumin dhe magnesium, nëse këto metale nuk janë ndarë gjatë coptimit.

4.3.3 Të vecohen gomat, komponentët plastike, nëse këto materiale nuk janë ndarë gjatë procesit të coptimit.

4.3.4 Të vecohen materialet e qelqit.

4.4 Operacionet e ruajtjes duhet të kryhen në kryhen në mënyrë të tillë që të evitohen dëmtimet e pjesëve që përmbajnë lëngje apo të pjesëve dhe komponentëve të rikuperueshëm.

4.5 Procedura e pranimit të mbetjeve:

Përpara pranimit të mbetjeve të makinave të përdorura në vendin e grumbullimit, kryen procedurat e mëposhtme të hyrjes:

4.5.1 Kontrollon dokumentacionin e mbetjeve

4.5.2 Verifikon përputhshmërinë e mbetjeve me përshkrimin e dhënë në dokumentacionin e dorëzuar nga mbajtësi.

4.5.3 Lëshon dokument me shkrim për marrjen e çdo dërgese të pranuar në vend.

4.5.4 Plotëson regjistrin përkatës me sasitë dhe karakteristikat e mbetjeve të depozituara, duke shënuar origjinën, datën e dorëzimit, identitetin e gjeneruesit ose të grumbulluesit të mbetjeve shtëpiake.

4.5.5 Ky informacion i vihet në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për qëllime statistikore me kërkesë të saj.

4.6 Vetëmonitorimi i shkarkimeve të lëngëta ujore:

Treguesit që duhet të vetëmonitorohen, frekuenca e marrjes së mostrave dhe analizave listohet në tabelën e mëposhtme.

	Treguesit e matjes	Faza e Operimit
1	a. Lëndë të ngurta pezull	Çdo 3 muaj
	b. NBO5	Çdo 3 muaj
	c. NKO	Çdo 3 muaj
	d. Alumin	Çdo 3 muaj
	e. Arsenik	Çdo 3 muaj
	f. Barium	Çdo 3 muaj
	g. Kadmium	Çdo 3 muaj
	h. Krom total	Çdo 3 muaj
	i. Krom VI	Çdo 3 muaj
	j. Hekur	Çdo 3 muaj
	k. Merkur	Çdo 3 muaj
	l. Nikel	Çdo 3 muaj
	m. Plumb	Çdo 3 muaj
	n. Bakër	Çdo 3 muaj



5. Raportimi i të dhënave mjedisore

- Në zbatim të kërkesave ligjore subjekti duhet të bëjë vlerësimin mjedisor periodik të veprimtarisë së tij
- Për të mbajtur informacionin mbi monitorimin, zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore subjekti duhet të përpilojë një regjistër të veçantë.
- Të dhënat e vetëmonitorimit dhe të zbatimit të kushteve të Lejes Mjedisore duhet ta vërë në dispozicion të institucioneve shtetërore, si dhe të interesuarve të tjerë.
- Për çdo ndryshim të planifikuar në teknologji, operacione të paparashikuara dhe deklaruar në raportin e VNM-së, të njoftohet menjëherë ARM.
- Të njoftohet ARM, në çdo kohë, për aksidente ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis.
- Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët si dhe të njihen me termat e Lejes Mjedisore dhe pasojat e mos zbatimit të tyre në mjedis dhe në marrëdhëniet e subjektit me organin e dhënies së Lejes Mjedisore.
- Për të gjitha termat e mësipërme të Lejes Mjedisore zbatimin, subjekti është i detyruar të dorëzojë pranë ARM-së, një relacion shkresor në mënyrë periodike (çdo tre muaj), nga fillimi i operacioneve të ndërtimit deri në përfundim, ndërsa në shfrytëzim një raport për mënyrën e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore (çdo 6 muaj).

6. Vlefshmëria e lejes së mjedisit

- Kjo leje është e vlefshme pasi veprimtaria të liçensohet nga institucionet përkatëse.
- Mosfillimi i aktivitetit brenda një periudhe dy vjecare sjell për pasojë pavlefshmërinë e lejes për ushtrimin e këtij aktiviteti.
- Shfaqja e elementëve të rinj ekologjike të panjohura, në kohën që kjo leje është dhënë bën rivlersimin ose heqjen e lejes.

- Kjo leje është e vlefshme vetëm për aktivitetin “grumbullim dhe përpunimi i materialeve hekur/ jo hekur” për aktivitet “vendepozitim i mbetjeve” dhe “impiant për prodhim biogazi” subjekti duhet të aplikojë për leje tjetër mjedisore.

7. Të zbatohet kuadri ligjor i cituar më poshtë:

- Ligji nr. 9890, datë 20.03.2008 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji Nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji Nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedisit”
- Ligji Nr. 9108, datë 17.07.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”
- Ligji Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe shtesat e tij
- Ligji Nr. 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”
- Ligji Nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”
- VKM Nr. 453, datë 23.06.2005 “Për miratimin e listës së pajisjeve, që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese”.
- VKM Nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse”.

8. Sanksionet e mundshme:

Për mos respektimin e kushteve të Lejes Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor ka sanksione ligjore:

- a) Ndësjkimi administrativ dhe penela i subjektit që nuk zbaton kushtet e lejes.
- b) Pezullimi i lejes mjedisore për një afat kohor të caktuar ose përgjithmonë.

9. Vlerat e tarifës së shërbimit të lejes mjedisore

Mbështetur në Udhëzimin Nr. 5, datë 28.12.2007 “Për përcaktimin e tarifave të lejeve të mjedisit” leja e mësipërme klasifikohet nëme klasifikohet në pikën 12 gërma “i”.

Vlera e tarifës së shërbimit të lejes mjedisore është 50 000 Lekë.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM
JULIAN BEQIRI**

